


BIBLIOTEKA  
SHTETIT

B/H-1  
R 95

Skënder  
Rusi

... I BABA  
I NJOME ISHTE  
I NJOME ISHTE

poezi



814-1  
R 95

SKENDER RUSI

# I NJOMË ISHTE BARI...

— poezi —



SHËTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

Tirazhi 1.000 kopje      Format 70x100/32      Stash: 2204-72

---

Shtypur: Kombinati Poligrafik  
Shtypshkronja «Mihal Duri» — Tiranë, 1975

## THASHË VETËM NJË FJALË

— Kur u plagosa për herë të parë,  
pëshpërta me buzët që më digje-  
shin: Parti! —

... Thashë vetëm një fjalë,  
nuk mundja dot më tepër.  
I mbaja zorrët në pëllëmbë,  
në bark e kisha predhën.

Nuk mundja.

E kisha tepër të rëndë...

Dhe më duket, megjithatë,  
se i thashë të gjitha.  
Në atë fjalë ishte tërë lufta që bëmë,  
në atë fjalë, për të cilën edhe mund të vdisja.

## D U H E T !

Ne dimë se ç'bëjmë,  
kur bëjmë diçka,  
kjo do të thotë se patjetër duhet.

Duhet  
edhe mbi tavolinë  
të përplasësh grushtat.

Duhet  
edhe përtej lodhjes  
të mos ulesh.

Duhet  
edhe po qe i verbër  
ta shohësh mirë udhën.

Duhet

ta mbash gjithnjë pranë vetes  
pushkën dhe kazmën.

Duhet

barutin mos e zerë lagështia,  
dhe koskat të mos të ndryshken  
nga plogështia,

sepse armiku pret e përgjon  
dhe aherë kur qielli duket i kaltër,  
dhe aherë... po, dhe aherë...

Duhet,

sepse jemi betuar  
mbi gjakun e mijëra të rënëve  
për këtë tokë,  
që populli i ktheu në lapidare!

## NE SHQIPTARËT...

Ne shqiptarët jemi të qeshur,  
kur derdhim djersë mbi ara dhe mbi torno,  
dhe kjo do të thotë se jemi të lumtur.

Ne shqiptarët ecim krah njëri-tjetrit  
në rrugën për në komunizëm,  
dhe kjo do të thotë se u ngjajmë maleve tona.

Ne, shqiptarët, asnjëherë  
s'u gjunjëzuan para rrebesheve dhe shtrënga-  
tave të shekujve,  
dhe kjo do të thotë se armiqtë na njohin se  
ç'jemi!

## ASNJËHERË NË HISTORINË E ZOGJVË

Asnjëherë në historinë e zogjve  
s'ka patur shqiponjë me dy kokë.  
Dhe asnjë tjetër në historinë e popujve  
s'ka patur madhështinë e saj.

Në dorën e majtë shqiptarët  
si armë të tyre mbanin shqiponjën.  
Shpatën kishin në të djathtën,  
me to e kanë çarë kohën.

Toka u kish dhënë hekur,  
me të kishin bërë shpata e hanxharë.  
Kur s'kishte më grurë në kështjellë,  
ata kanë ngrënë edhe bar.



## M E R R N I . . .

Merrni këngët e mia  
dhe u vini krahë!  
Ato prapë do të fluturojnë  
pranë tokës.

Merrni dëshirat e mia  
dhe u hidhni prangat!  
Ato prapë do të thërresin  
në emër të Shqipërisë sime.

Merrni vajzën time  
dhe i thoni që s'e dua,  
ajo prapë do të mbështesë kokën  
mbi gjoksin tim.

Merrni sytë e mi  
dhe i krahasoni me detin,  
Joni është njëri,  
Adriatiku — tjetri.

## A T E D I T Ë . . .

Atë ditë kur i solla këto vjersha,  
këtu te ky pallat i madh, i bukur,  
kish kohë që kishte hyrë vjeshta  
dhe shumë zemra gjethesh kishte këputur

Netë pa gjumë unë mbaja në duar,  
sy të qeshur, gjokse tërë jetë  
dhe ecja si djalosh i dashuruar  
me njerëzit, rrugët, qytetin.

Kisha ardhur larg nga fshati im  
te ky pallat i madh i Komitetit. . .  
Në zemër më pat çelur si agim  
dashuria e madhe e poetit.

## QENKA E BUKUR LIRIA!

Liria qenka e bukur,  
të shëroka e të bëka të lumtur!

Dhe sytë të qeshkan vetë,  
dhe qielli i dimrit të duket i kthjellët.

Ajri i tejdukshëm, pa ushtarë të huaj rrugët,  
ne e deshëm paqen, ndaj e bëmë luftën.

Ne i deshëm fëmijët të rriten pa halle,  
ndaj lamë edhe krahët andej nëpër male.

## M B I N J Ë B R A Z D Ë

Te kjo brazdë shoh bukën dhe jetën,  
ndaj s'ankohem kurrë për lodhjen.  
Edhe kafshët, në qoftë se do t'i pyesësh,  
mbi atë brazdë e kanë qejf ngordhjen.

Nga buzët u rrjedhin jargë të gjata,  
gjë e zakonshme për qetë.  
Ato bien mbi dheun e vlagët  
edhe bëhen bukë dhe jetë.

Le të thonë të tjerët ç'të duan...  
Kjo brazdë shkon deri te dielli,  
socializmin ndaj e dashuruam  
dhe për të edhe jetën e mbjellim!

Ishte 70 vjeç, kur vdiq xha Velishau,  
kur një brazde ia fali jetën,

kur u shtri mbi gjurmët e kaut  
si mbi një copë dheu të vjetër.

Edhe mbeti në sytë e të tjerëve  
si një dashuri që kurrë s'do të tretet.  
Do të desha në sytë e njerëzve  
si ky bujk i ndershëm të mbetem!

## M O N O L O G I N T I M

Kisha një shoqe  
me flokët dallgë-dallgë,  
në shpirt e në ndjenja  
me mua ngjante.

Në duart e saj,  
me kallo e të bukura,  
unë i vija buzët  
edhe i puthja.

Dhe ato mbeteshin  
në buzët e mia,  
si dy dëshira të bukura,  
si dy trëndafila.

## Ç' T E B È J A ?

Ç'të bëja?  
Unë s'kisha të drejtë të qeshja,  
po më vdiste nëna.

Pa bukë,  
pa zjarr,  
pa një çikë diell,  
vetëm me zemrën time të thyer.

Kur u gdhi,  
ajo ishte bërë akull.

Dhe ashtu e varrosa,  
nuk e shkriua dot.  
Dhe isha aq i vogël,  
përrjashta binte borë.

Dola në rrugë,  
më qëlluan me topa bore  
fëmijët e beut.

Jashtë ishte bukur,  
po nënën do të ma shtypte dheu.

Oh, nënë,  
arkivoli yt  
qenka kaq i rëndë!  
Dhe unë jam kaq i vogël,  
kush do të m'i përkëdhelë flokët?!...

Veç era përgjigjej  
me zërin e saj të egër.  
(Unë pyesja nënën,  
ç'i duhej erës?!)

Veç dëbora më vinte  
duart e saj mbi flokë.  
(Desha duart e nënës,  
ç'i desha duart e borës!)

Ç'të bëja?  
Mbeta pa nënë.



Si një mbrëmje e zezë,  
kur ia vjedhin hënën.

Pa njeri në botë,  
dhe ishte dimër atëherë,  
dhe unë isha i vogël.

## U N Ë I K A...

Në goftë se atëherë  
i lashë delet e zeza të beut  
dhe ika maleve,  
kjo do të thotë  
se e dija ku shkoja.

Unë ika,  
ato u shpërndanë malit  
me qindra blegërima,  
kërkonin çobanin.

Dhe ishte vjeshtë atëherë,  
gjethet binin nga pema,  
Në barkun e deleve  
blegërinin shqerrat.



Unë ika.

E dija se shiu  
do të ishte prej plumbi  
dhe prej hekuri — buka.

E dija se këtë dhe  
me gjak mund ta skuqja,  
por kjo nuk më ndalte,  
ish toka ime, fundja.

E dija se për lirinë  
do të bëja më tepër nga ç'mundja,  
dhe pa tjetër top  
do të më bëhej pushka.

## MEDITIM I NJË BUJKU

Vërtet, koka më dhemb,  
por kjo s'do të thotë ta lë punën,  
duhet mbjellë toka!

Sikur pemët të thyheshin  
nga çdo erë që frynte,  
s'do të kishim as pemë.  
s'do të kishim as kokrra.

## NUK DUHET

*Kur shkoja si mësues  
në fshatin ku më caktuan.*

... Do të gjej njerëz të mirë edhe atje,  
ku kam menduar se mund të jem i vetëm.  
Nuk duhet të trishtohem, sepse  
në këtë mënyrë mund t'i fyej njerëzit.

Nuk duhet... sikur më flet edhe ky lumë i vogël,  
edhe drurët që lëvizin në ujin e tij.  
Nuk duhet... më pëshpërisin në vesh edhe zogjtë,  
edhe dielli më vështron si njeri.

O, po kjo është kaq njerëzore,  
si kjo erë që më përkëdhel nga afër,  
si kjo pëllëmbë fshatari që më mbeti në dorë,  
si kjo rrugë e panjohur dhe e dashur.

## NJERIU I GUROREVE

*25 vjet nëpër gurë e male,*

*25 vjet i dashuruar...*

Dy grushta  
si dy shkëmbinj të ashpër.

Gishtat e tij  
pak të shtrembër  
si udhët e gurores.

Dy krahë burri  
si dy baromina...

Por ai  
s'është vetëm ky...

Ai di  
të buzëqeshë edhe me gurët.

Di të diskutojë,  
dhe të ngrerë normat,

di të mësojë  
edhe në shkollën e natës,  
di të përkëdhelë ëmbël  
edhe fëmijët.

## SHQËTËSIM

Është një mësues te një fshat i bukur,  
që di shumë gjëra që fshatarët s'i dinë,  
por atë s'e përfillin, bile edhe rrugët  
i ngrejné pluhur dhe ia shtojné mërzinë.

Ai nuk u flet fshatarëve në rrugë  
edhe psherëtin, dreqi e marrtë!  
Harron se fshatarët e rritën me bukë  
dhe i dhanë shkollë të lartë.

Ju pse habiteni, o njerëz të mirë,  
me këtë mësues në këtë fshat të bukur,  
që di shumë gjëra që fshatarët s'i dinë,  
por që s'e përfillin as njerëzit, as rrugët?!



## SHOKU IM QË S'ERDHI NË AKSION

... Erdhën vajzat te konvikti ynë,  
dielli zgjati kokën te dritarja jote.  
Ti flije,  
më the që mbrëmë se s'do të vije.

(Edhe dielli u revoltua,  
erdhi e u var te dritarja jote,  
për të të zgjuar.)

Por ti s'doje të çoheshe.

Ne ikëm.  
Aksioni do të kryhej edhe pa ty...

Ikëm.

... Shokët më pyetën për ty,  
qepallat e tyre si pikëçuditje  
ma shponin gjoksin...

Unë korrja misër i heshtur,  
dhe ndodhte të të përfytyroja dhe ty,  
dhe më dukeshe tmerrësisht i vockël.

## DIELLI LINDTË

*Tregim i gjyshit për fëmirinë*

Dielli lindte,  
por s'kisha të drejtë  
të ndieja gëzim.

Lulet ishin të bukura,  
por unë  
s'kisha të drejtë t'i këputja.

Rrugët ishin të gjata,  
por unë s'kisha të drejtë  
të ecja në to.

Vitrinat e tregtarëve ishin plot,  
por unë s'kisha të drejtë  
të thyeja xhamet...

Hëna ishte e bukur,  
por ajo nuk hynte kurrë  
në dritën time.

Dëbora ishte e bardhë,  
dhe me flokët të mëdhenj binte  
fëmijët e beut qeshnin,  
ndërsa ne, varfanjakët, qanim gjer në  
dhibbje.

## O PROLETARË TË AMERIKËS!

Ç'do të thotë të jesh pa të drejta,  
të të lenë pa ajër, pa diell,  
të ta futin edhe zërin në hekura,  
të mos kesh as të hënë... as të diell!?

Ç'do të thotë të mos kesh mundësi  
t'i thuash pranverës, për shembull,  
— «Më sill ca diell!»,  
t'i thuash pranverës, për shembull,  
— «Më prit,  
mbi barin tënd grushtat do t'i mbjell»?

Ç'do të thotë të jesh i varfër,  
në Shtetet e Bashkuara të Amerikës?  
Tregojeni ju, mijëra proletarë,  
në grushtin tuaj qeveria sheh frikën.

Ngrini zërin edhe më fort,  
i thyeni hekurat e padrejtësitë,  
të jeni dhe ju ushtri e revolucionit,  
o proletarë të Amerikës!

## DHEMBJA E NJË ZEZAKU TË VOGEL

Dyert refuzojnë të hapen për dorën time,  
dhe më falin ftohtësinë në vend të përshëndetjes.

Qenka jo e lehtë për sytë e një fëmije,  
të vdesësh ditën, e pikërisht në mëngjes.

Unë mund të punoj edhe 18 orë, edhe natën,  
për nënën time të mirë zezake.

(Unë mund të punoj edhe 10,  
edhe 14, edhe 24 orë.)  
Jam fëmija më i fyer zezak,  
dhe fëmija më i mjerë në botë.

Qenka jo e lehtë për sytë e një fëmije,  
të vdesësh ditën, e pikërisht në mëngjes,  
që mund të jetë i bukur për të gjithë,  
veç jo për prindët me ngjyrë të zezë.

## N E N E S I M E

Ti bjerë e fli, moj nëna ime,  
gjithë ditën ke punuar,  
s't'u ndanë kurrë shqetësimet,  
s't'u lodhën ato duar.

E di, moj nënë, mos ma thua j...  
ke qejf të më rrish pranë,  
dhe të më shohësh, kur të shkruaj  
unë vjershat që s'm'u ndanë.

Po ti kështu s'më le të qetë  
dhe s'mundem të punoj,  
se sytë e tu ngado më ndjekin,  
ndaj vargjet ngatërroj.

Megjithëse... kisha qejf, moj nënë,  
të rrinim dhe ta gdhinim.



A të kujtohet ç'më ke thënë,  
kur ta lexoja ty Naimin.

«Ai e deshi jetën shumë,  
kjo duket dhe në letër,  
por dhe atdhenë, besoj unë,  
do ta ketë dashur tepër.

Unë shumë, o bir, nuk kam lexuar,  
por di veç të të them:  
poeti mbetet i harruar,  
pa dashuri që dhemb...

Pa zjarr që digjet thellë zemrës,  
pa vrull, synim të dli­rë,  
që njerëzit e kësaj toke  
t'i bëjë të gjithë të mirë!»

30 QERSHOR 1972

— Nga ditari i një studenti ushtar —

Është nata e fundit në barrakën ushtare,  
e nesërmja do të thotë ikje,  
më ngacmojnë parreshtur kujtimet djalosharë  
dhe mëngjeset e diellit në lindje.

Është një këngë në zërin e së cilës  
do të mbetem iso të paktën.  
Në Shqipërinë time edhe fëmijët e dinë  
çdo të thotë të vishesh ushtar!

Është nata e fundit dhe është vonë,  
e nesërmja do të thotë ikje.  
Po kujtimet gjithnjë do më çojnë  
te mëngjeset e diellit në lindje.

Po gjithnjë do të shkruaj për ta,  
nën dallgët e hovet e ndjenjës,  
dhe gjithnjë uniformën ushtare  
do ta kem kostumin e jetës.

## F U S T A N E L L Ë B A R D H Ë T

1920,  
det dhe italianë,  
Shqipëri e vogël,  
fustanellëbardhë,

me 40 milionë,  
me një mbret të madh,  
me grykat e topit  
luftonin ata.

Nga malet e gurtë  
shqiptarët dilnin.  
Gratë u lidhnin plagët,  
ata prapë shtinin.

«O, t'i biem qenit!  
Ja, për këto brigje!

Jemi apo ç'jemi,  
nuk fitohet ndryshe.»

E kishin Lirinë  
në sy e në ballë.  
Luftonin me pushkë  
edhe me hanxharë.

E hodhën në det  
mbretërinë e madhe.  
Ushtarët ia hodhën  
nëpër shkumë dallge.

Mbi shkëmbinjtë e detit,  
mbi brigjet e tyre,  
mbetën shqiptarët,  
fustanellëbardhët.

Ë Ç'ISHIM NË?

E ç'ishim ne?  
Ç'kam qenë unë për shembull?  
Hiç,  
ose pothuaj asgjë.

Unë kisha gojën,  
po beu  
më kish vjedhur zërin.

Kisha sytë,  
po beu  
më kish vjedhur shikimin.

Kisha duart,  
po beu  
më kish vjedhur grushtat.

Kisha këmbët,  
po beu  
më kish vjedhur hapat.

Kisha delet e tij,  
po beu  
më kish vjedhur qumështin.

Kisha mushkëritë,  
po beu  
më kish vjedhur ajrin.

Të gjitha.

Të gjitha.

Të gjitha.

## NE S'DUAM RE...

Ne s'duam re, mjegull edhe muzgje  
në qiellin tonë të gjerë e të kaltër,  
por ndodh të shfaqet befas ndonjë re,  
që dëshëron në gjithë qiellin të zgjasë krahët.

Dhe është për të qeshur,  
mund të rritet reja  
nën një diell të madh,  
nën një qiell gjithnjë të kaltër  
dhe të kthehet në borë pastaj?!

Ne gjithnjë ecim,  
dhe rritemi,  
bëhemi më të fuqishëm e më të bukur,  
siç rritet gruri nëpër mëngjese,  
siç rritet gonxhja në një trëndafil  
të kuq,

siç rritet oxhaku në një uzinë të re  
dhe mbi një lumë tjetër ngrihen diga.  
Ne dimë të ecim, edhe në qoftë se  
na kërcënojnë armiq  
edhe intriga.



## D Ē S H M O R Ē V E

Ju u mbështetët në  
gjoksin e bronctë të përjetësisë  
kur kohërat dridheshin mes krismash  
për të nesërmen.

Dhe aq shumë rendët për këtë agim të bardhë,  
sa s'ka rendur kush në këto male,  
mbi shpinë e morët dhe ne na e sollët  
dhe tani çlodheni mbi piedestale.



Ai s'kish parë kurrë dëborë,  
veç kish dëgjuar në përrallat e vjetra.  
Ish rritur në brigjet e Jonit,  
pranë detit me dallgë të egra.

Ndaj rrugën e kishte të vështirë  
dhe ecjen pothuaj të pamundur.  
Dhe ish njeri i ndershëm dhe i mirë,  
luftonte në Veri dhe kish ardhur nga Jugu.

Dhe s'kish, pothuaj, asnjë shpresë,  
mund të vdiste atë mbrëmje të mugët,  
«Më prit, o partizan!» — dëgjoji një zë,  
po zëri nuk dukej, ku ishte futur.

Kthen kokën dhe në gjurmët e tij,  
mbi dëborën me lule gjaku,  
zëri që dëgjoji u bë njeri  
dhe vazhdoi t'i vinte më afër.

Pse ec ky njeri, mbas gjurmëve të mia?  
Kësaj nuk i dha dot përgjigje.

. . . . .  
. . . . .

Kur u përmend, ishte gdhirë  
dhe pranë i qëndronte ai që e ndiqte.

Një malësor, me qeleshe të bardhë,  
me dy sy që shprehnin dhimbje dhe dashuri.  
Dhe u kujtua se ndodhej pranë zjarrit  
dhe aq pranë popullit të tij.

## EPILOG I NJË DITARI PARTIZAN

U vrava  
në një dimër të tmerrshëm.  
për një rrugë të drejtë,  
për një popull të ndershëm,

për dy sy të një nëne  
për një diell të bardhë,  
për një vajzë çapkëne  
që m'i lidhte plagët.

Ky gjak mbi dëborë  
le t'ju flasë më tepër,  
dhe këto pika gjaku,  
kur shkrova këtë letër.

## ISH I NJOMË BARI I GJELBËR

*Partizanit dëshmor,  
Shyqyri Kambo.*

Dhe u shtri ngadalë mbi lëndinë  
me faqen e majtë mbi barin e gjelbër.  
Në burimin e syve të tij  
mbeti pasqyruar dielli edhe pemët.

Në gjoksin e shpuar i hapi fletët  
një trëndafil i madh e i bukur,  
dhe ishte i njomë bari i gjelbër,  
dhe ishte i hidhur ajri i luftës.

Dhe buzët i mbetën të çelura,  
sikur pëshpërisnin akoma këngën e beharit...  
«I thoni nënës mos vishet me të zeza,  
le t'më kërkojë në fijet e barit!»...

ATË NATË TË '44

Më zgjuan qentë me klithma dhe lehje,  
hëna iku nga dritarja ime,  
yjet e lodhur digjeshin në dehje,  
rrugët u mbushën me zëra dhe hije.

Duart nënokes ia mbërthyen në hekura.  
Po para pushkëve nxirrte gjoksin — shkëmb.  
O ju, që mbani në kokë helmata  
jeta me këngë ne s'na dhëmb.

Nënokes mund t'i bëni ç'të doni,  
mund ta varni edhe në qiell,  
po hapat e saj gjithnjë do t'i ndiejmë,  
kur të ecim në shi a në diell.

## N E K E T E M A L . . .

Në këtë mal u shtua një liqen i bukur  
nga duart e djemve dhe të vajzave.  
Dhe është i vetmi popull ky,  
që gjeografinë e ndryshon çdo sekondë.

Dhe është e vetmja Parti kjo,  
gjithnjë e drejtë dhe si ky liqen e pastër,  
Shqiptarët janë një popull i vogël,  
po komunizmin po e sjellin gjithnjë e më afër.



## PËRMBAJTJA E LËNDEËS

	faqe
Thashë vetëm një fjalë .....	3
Duhet .....	4
Ne shqiptarët .....	6
Asnjëherë në historinë e zogjve .....	7
Merrni .....	8
Atë ditë .....	9
Qenka e bukur liria! .....	10
Mbi një brazdë .....	11
Monolog intim .....	13
Ç'të bëja? .....	14
Unë ika .....	17
Meditim i një bujku .....	19
Nuk duhet .....	20
Njeriu i guroreve .....	21
Shqetësim .....	23
Shoku im s'erdhi në aksion .....	24
Dielli lindte .....	26
O proletarë të Amerikës! .....	28
Dhembja e një zezaku të vogël .....	30
Nënës sime .....	31
30 qershor 1972 .....	33
Fustanellëbardhët .....	34
E ç'ishim ne? .....	36
Ne s'duam re .....	38
Dëshmorëve .....	40
Në vitin '42 .....	41
Epilog i një detari .....	44
I njomë ishte bari .....	45
Atë natë të '44 .....	46
Në këtë mal .....	47

